



SHKOLLA E LARTE UNIVERSITARE JOPUBLIKE
LUARASI



**SHKOLLA E LARTË UNIVERSTITARE
JOPUBLIKE "LUARASI"**

Nr. 139 Prot., datë 06.07.2016

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PATENTAVE DHE MARKAVE**

Nr. 219 Prot., datë 6.7.2016

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE
përfaqësuar nga Z. Elvin LAKO - Drejtor i Përgjithshëm i DPPM**

&

**SHLUJ "LUARASI"
Përfaqësuar nga Zj. Nevila XHINDI – Rektore**

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe SHLUJ "LUARASI" bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët në Marrëveshje

Palët e kësaj marrëveshjeje do tëjenë **Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM)** dhe **SHLUJ "LUARASI"**.

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave e njohur më poshtë si "**DPPM**", është institucion publik, që siguron dhënien dhe mbrojtjen e objekteve të Pronësisë Industriale, në fushat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit, markave tregtare dhe të shërbimit, disenjove industriale, treguesëve gjeografikë, topografive dhe qarqeve të integruara. Zyra për regjistrimin e Markave Tregtare ka funksionuar pranë Dhomës së Tregtisë së Shqipërisë që në vitin 1957. Me Ligjin Nr.7819 veprimtaria e Dhomës së Tregtisë i kaloi Zyrës së Patentave dhe Markave (DPPM) e cila u krijuar me V.K.M Nr.135, datë 22 Mars 1993. Sot, Drejtoria Përgjithshme e Patentave dhe Markave është institucion publik në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Veprimtaria e DPPM përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin Nr.9947 datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, i regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me numër identifikimi K51726018J. Adresa e institucionit është: Bulevardi "Zhan D'Ark", ish Shtëpia e Ushtarakëve, Prana Nr.33, Tiranë.

1



SHLUJ “LUARASI”, person juridik, që është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e tij në përpunje me dispozitat e Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 “PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i ndryshuar me ligjet Nr.9832, datë 12.11.2007 dhe Nr.10 307, datë 22.7.2010, si dhe me statutin e tij dhe dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, me qëllim ofrimin e mundësive për arsimim në të dyja ciklet e studimit sipas legjislativit të lartpërmendur, për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që shprehin interes.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një bashkëpunimi të dy palëve të lartpërmendura në kuadër të informimit dhe sensibilizimit të studentëve të SHLUJ “LUARASI” dhe i rretheve të tyre sociale, duke iu vënë në dispozicion dispozitat ligjore mbi pronësinë industriale, promovimi i pronësisë industriale nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve tona, si dhe identifikimi i masave të mbrojtjes së pronësisë industriale.

Neni 3

Objektivat e Marrëveshjes

Objektivi kyesor i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është të lehtësojë njojen e konceptit të pronësisë industriale nëpërmjet:

- 1- Identifikimit të mekanizmave të shpërndarjes së informacionit në lidhje me pronësinë industriale, ku në bashkëpunim me studentët t'i përçohet informacioni dhe njouria subjekteve, bizneseve dhe përdoruesve të tjerë të pronësisë industriale.
- 2- Shpërndarjes së materialeve informuese në lidhje me bizneset, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me pronësinë industriale.

Neni 4

Rëndësia e Bashkëpunimit

Rëndësia e këtij bashkëpunimi qëndron në faktin se:

- 1- Pronësia Industriale është një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomike.
- 2- Ekziston një nevojë imediate për mbështetjen ligjore dhe institucionale të pronësisë industriale, me qëllim mbrojtjen e subjekteve të kësaj pronësie.
- 3- Palët janë të interesuara të promovojnë dhe të përmbytishin objektivat e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë industriale, si dhe të drejtave të Institucioneve të Arsimit të Lartë që angazhohen në këto veprimtari.
- 4- Palët shprehin dakortësinë mbi rëndësinë e ndërgjegjësimit publik mbi pronësinë industriale, përsa i përket kontributit të rëndësishëm të Institucionit të Arsimit të Lartë SHLUJ “LUARASI”, në zhvillimin edukativ arsimor të Shqipërisë.

2

Neni 5

Përgjegjësitë e Palëve


Në përputhje me Nenet 2 dhe 3, palët në këtë marrëveshje bien dakord të angazhohen në përbushjen e kompetencave dhe përgjegjësive përkatëse.

4.1 Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave (DPPM):

- a) Zbatimi i marrëveshjes nga ana e DPPM do të jetë nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit të Pronësisë Industriale dhe Trajnimit.
- b) Informimi i zhvillimit të aktiviteteve dypalëshe, nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës pranë SHLUJ “LUARASI”.
- c) Promovim të SHLUJ “LUARASI” në rrjetet sociale të DPPM.
- d) Përpunimi, zbatimi dhe monitorimi i planveprimit të saj si drejtori në kuadër të kësaj marrëveshje.
- e) Organizimi dhe vënia në dispozicion për publikun e gjërë, e informacionit dhe rezultateve të çdo veprimtarie të përbashkët, përmes medias dhe rrjeteve sociale.
- f) Ofrimin dhe mundësimi i programeve të intershipi-t për studentët e SHLUJ “Luarasi”.
- g) Ofrimi dhe mundësimi i trajnimit të studentëve të SHLUJ “LUARASI” mbi rëndësinë e pronësisë industriale.
- h) Organizimi i konferencave të përbashkëta, trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, internshipeve, leksioneve të hapura, seminareve, sesione bisedimesh (workshops), praktikave mësimore apo takimeve në fushën e biznesit, dhënien e njohurive praktike nga specialistët e kësaj drejtorie, përsa i përket pronësisë industriale.
- i) Shkëmbim i ndërsjelltë i informacionit në lidhje me funksionin dhe kontributin e SHLUJ “LUARASI” në zhvillimin, zgjerimin dhe sensibilizimin e opinionit publik.

4.2 Kompetencat dhe përgjegjësitë e SHLUJ “LUARASI”

- a) Zbatimi i marrëveshjes nga ana e SHLUJ “Luarasi” do të jetë nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.
- b) Informimi i të gjithë studentëve rreth aktiviteteve të përbashkëta me DPPM.
- c) Organizimi i studentëve që dëshirojnë të jenë pjesë e diskutimeve konstruktive, seminareve, trajnimeve, leksioneve të hapura, internshipeve, praktikave mësimore, apo edhe i organizimeve të tjera në kuadër të kësaj marrëveshje.
- d) Ofroimi i asistencës dhe lehtësirave për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, si dhe akses që të koordinojnë veprimtaritë e përbashkëta.



3



- e) Ndjekja e veprimtarive të përbashkëta në funksion dhe dobi të studentëve në përputhje me interesat e tyre.
- f) Koordinimi i veprimtarive të përbashkëta në përmbushje të planifikimeve në akord me këtë marrëveshje.
- g) Organizimi dhe vënia në dispozicion për publikun e gjërë, e informacionit dhe rezultateve të çdo veprimtarie të përbashkët, përmes medias dhe rrjeteve sociale.
- h) Shkëmbim i ndërsjelltë informacioni në kuadër të kësaj marrëveshje.

Neni 6

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme për një periudhë pa afat deri në rastet kur palët me vullnetin e tyre bien dakord për të zgjidhur këtë marrëveshje pas njoftimit paraprak me shkrim që parashtron edhe arsyet e prishjes së marrëveshjes.

Neni 7

Ndërprerja e Marrëveshjes

- Çdo kundërshtim midis palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të rregullohet nëpërmjet negociatave miqësore.
- Mospërmbushja e përgjegjësive të palëve sipas Nenit 5, do të sjellë prishje të kësaj marrëveshjeje.

Neni 8


Dokumentimi i Marrëveshjes

Nënshkruar në Tiranë, më 06.07.2016 në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE
JOPUBLIKE "LUARASI"
Zj. Nevila XHINDI



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PATENTAVE DHE MARKAVE
Z. Elvin LAKO


4